

2. Institucionet e **MARRREVESHJE** ndihma juridike dhe institucioneve te tjera, ne vendet e cilave hyjne ceshtjet e perandura ne shtet.

**NDERMJET REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE FEDERATES RUSE  
PER NDIHME JURIDIKE DHE MARRREDHENIET JURIDIKE  
PER CESHTJE CIVILE, FAMILJARE DHE PENALE**

Republika e Shqiperise dhe Federata Ruse, duke i dhene nje kuptim te rendesishem zhvillimit te bashkepunimit ne fushen e dhenies se ndihmes juridike per ceshtje civile, familjare dhe penale.

u moren vesh per sa me poshte vijon :

ndihma juridike per shprehje kryesore e veprimit procedural te perfaqshkuesve nga legjislacioni i Paleve Kontraktuese qe i kerkohet ndihma, ne vendet, marr **PJESA E PARE** te pandehurje dhe, te gjykarve, lexmilitareve, ekspertëve, shqyrtuesve, shqyrtuesve gjyqesor, detyron e provave material, ndihjen e procedurave penale, detyron dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqesore per te drejtat civile, dorazimin dhe dergimin e dokumentave, perfaqesimeve si dhe kerkesave te paleve, te detyron per shprehje te pandehurjeve.

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1**

**Mbrojtja Juridike**

1. Shtetasit e njeres Pale Kontraktuese qe zojne ne territoret e Paleve tjeter Kontraktuese ne lidhje me te drejtat personale dhe pasurore po ate mbrojtje juridike si dhe shtetasit e Paleve tjeter Kontraktuese.

Keto te drejta i qe zojne edhe personat juridike, te krijuar sipas legjislacionit te Paleve Kontraktuese.

2. Shtetasit e njeres Pale Kontraktuese kane te drejte qe lirisht dhe pa pengese t'i drejtohen gjykatave, prokurorive, zyrave noteriale ( te emeruar me poshte "institucione te drejtesise") dhe institucioneve te tjera te Paleve tjeter Kontraktuese, ne kompetencen e te cilave hyjne ceshtjet civile, familjare dhe penale, mund te hyjne ne marrredhenie me to, te ngrene padi, te paraqesin kerkesa dhe te realizojne veprime te tjera proceduriale ne po ato kushte si dhe shtetasit e vet.

**Neni 2**

**Ndihma juridike**

1. Institucionet e drejtesise te Paleve Kontraktuese japin ndihme juridike reciproke per ceshtjet civile, familjare dhe penale ne perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshje.

2. Institucionet e drejtesise i japin ndihme juridike dhe institucioneve te tjera, ne kompetencat e te cilave hyjne ceshtjet e permendura ne piken 1.

3. Institucionet e tjera ne kompetencen e te cilave hyjne ceshtjet e permendura ne piken 1, i drejtojne kerkesat per ndihme juridike permes institucioneve te drejtesise.

### **Neni 3**

#### **Volumi i ndihmes juridike**

Ndihma juridike perfshin kryerjen e veprimeve proceduriale te parashikuara nga legjislacioni i Pales Kontraktuese qe i kerkohet ndihma, ne vecanti, marrja ne pyetje e te pandehurve dhe te gjykuarve, deshmitareve, eksperteve, berjen e ekspertizave, shqyrtimin gjygesor, dhenien e provave materiale, nisjen e procedimit penal dhe dorezimin e personave qe kane kryer vepra penale, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjygesore per te drejtat civile, dorezimin dhe dergimin e dokumentave, paraqitja sipas kerkesave te pales tjetere te te dhenave per gjykimin e te pandehurve.

### **Neni 4**

#### **Rregulli i lidhjeve**

Per dhenien e ndihmes juridike, institucionet e Paleve Kontraktuese, lidhen midis tyre permes Ministrise se Drejtesise dhe Prokurorise se Pergjithshme te Republikes se Shqiperise dhe Ministrise se Drejtesise dhe Prokurorise se Pergjithshme te Federates Ruse.

### **Neni 5**

#### **Gjuha**

Kerkesat per dhenien e ndihmes juridike behen ne gjuhen e Paleve Kontraktuese qe kerkon, ne qofte se ne kete Marreveshje nuk eshte parashikuar ndryshe.

### **Neni 6**

#### **Pergatitja e dokumentave**

Dokumentet qe i dergohen Institucionit te drejtesise ose organeve te tjera sipas rregullit te dhenies se ndihmes juridike, duhet te vertetohen me vule.

**Neni 7**

**Forma e kerkeses per dhenien e ndihmes juridike**

Ne kerkesen per dhenien e ndihmes juridike duhet te tregohet :

1. Emertimi i institucionit qe kerkon;
2. Emertimi i institucionit prej te cilit kerkohet;
3. Emertimi i ceshtjes per te cilen kerkohet ndihma juridike;
4. Emrat dhe mbiemrat e paleve, te te pandehurve, te te gjykuarve, te te denuarve, shtetesia e tyre, profesioni dhe vendbanimi i perhershem dhe vendqendrimi;
5. Mbiemrat dhe adresat e perfaqesuesve te tyre.
6. Permbajtja e kerkeses dhe per ceshtjet penale edhe pershkrimi i rrethanave konkrete te vepres penale te kryer dhe kualifikimi juridik i saj.

**Neni 8**

**Rregulli i permbushjes se kerkeses**

1. Per permbushjen e kerkeses per dhenien e ndihmes juridike, institucioni i drejtesise ndaj te cilit i eshte drejtuar kerkesa, zbaton legjislacionin e shtetit te vet. Megjihate, me lutjen e institucionit nga i cili vjen kerkesa, institucioni mund te perdore normat proceduriale te Pales Kontraktuese, nga e cila niset kerkesa perderisa ato nuk jane ne kundershtrim me legjislacionin e shtetit te vet.
2. Ne gofte se institucioni i drejtesise te cilit i eshte drejtuar kerkesa nuk eshte kompetent ta permbushe ate, ai ia dergon porosine institucionit kompetent te drejtesise dhe lajmeron per kete institucionin nga i cili niset kerkesa.
3. Ne rastin e marrjes se kerkeses perkatese, institucioni i drejtesise tek i cili eshte drejtuar kerkesa, lajmeron institucionin nga i cili niset kerkesa per kohen dhe vendin e permbushjes se kerkeses.
4. Pas plotesimit te kerkeses, institucioni i drejtesise ndaj te cilit eshte drejtuar kerkesa, i nis dokumentet institucionit qe ka bere kerkesen, ne rast se ndihma juridike nuk mund te jepet, atehere ajo kthen dhe njofton ate per rrethanat qe pengojne plotesimin e kerkeses.

**Neni 9**

**Menyra e dorezimit te dokumentave.**

1. Institucioni nga i cili kerkohen dokumentat i ploteson ato ne perputhje me rregullat qe veprojne ne shtetin e tij, ne rast se dokumentat jane hartuar ne gjuhen e tij ose jane te pajisura me perkthim te vulosur. Ne ato raste kur dokumentat nuk jane hartuar ne gjuhen e Pales Kontraktuese te kerkuar ose ato nuk jane shoqeruar me perkthime te vulosura, dokumentat i dorezohen marresit, ne rast se ai eshte dakord t'i marre.

2. Ne kerkesen e dorezimit duhet te jete treguar adresa e sakte e marresit dhe emertimi i dokumentit te derguar. Ne qofte se adresa e dhene nuk eshte e plote ose eshte e pasakte institucioni i pyetur ne perputhje me legjislacionin e tij merr masa per gjetjen e adreses se sakte.

**Neni 10**

**Konfirmimi mbi marrjen e dokumenteve**

Konfirmimi i dorezimit te dokumentave behet ne perputhje me rregullat qe veprojne ne territorin e Pales se pyetur Kontraktuese. Ne konfirmim duhet te jene treguar koha dhe vendi i dergimit dhe personi te cilit i eshte dorezuar dokumenti.

**Neni 11**

**Dergimi i dokumentave dhe pyetja e shtetasve nepermjet perfaqesuesve diplomatike dhe institucioneve konsullore.**

Palet Kontraktuese kane te drejte te dergojne dokumentat dhe te marrin ne pyetje shtetasit e tyre permes perfaqesuesve te vet diplomatike ose institucioneve konsullore. Per kete nuk mund te merren masa te karakterit te detyruar.

**Neni 12**

**Thirrja jashte shtetit e deshmitareve ose eksperteve.**

1. Ne qofte se gjate hetimeve paraprake ose shqyrtimit gjyqesor ne territoret e njeres Pale Kontraktuese lind domosdoshmeria per paraqitjen personalisht te deshmitareve ose eksperteve qe ndodhen ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese, atehere ata duhet t'i drejtohen organit perkates te kesaj Pale, per dorezimin e leter-thirrjes.

2. Leter-thirrja nuk permban sanksione ne rastet e mosparaqitjes te personit te thirrur.

3. Deshmitari ose eksperti, i cili pavaresisht nga shtetesia e tij, qe me vullnet te lire paraqitet sipas thirrjes ne organin perkates te Pales tjeter Kontraktuese, nuk mundet ne territoret e kesaj Pale te merret ne pergjegjesi penale ose administrative, t'i nenshtrohet nje mase sigurimi ose denimi per nje veper penale te kryer para se te kaloje ne kufirin e tij shteteror. Persona te tille nuk mund te merren ne pergjegjesi penale ose administrative, t'i nenshtrohen nje mase sigurimi ose te denohen lidhur me deshmitet e tyre ose ekspertimet qe lidhen me veperen qe perben objekt shqyrtimi.

4. Kete privilegj nuk e ka deshmitari ose eksperti, ne qofte se ai gjate 15 diteve, nga momenti i lajmerimit te tij se prania e tij nuk eshte e domosdoshme, nuk largohet nga territori i Pales Kontraktuese qe kerkon. Ne kete afat nuk llogaritet koha gjate te ciles deshmitari ose eksperti nuk mund te largohet nga territori i Pales Kontraktuese, por nga rrethanat qe nuk varen prej tij.

5. Deshmitaret dhe ekspertet qe paraqiten sipas thirrjes ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese, kane te drejte per shlyerjen e shpenzimeve nga organet qe i kane thirrur ata, te cilat lidhen me udhelimin dhe qendrimin jashte kufijve, dhe gjithashtu per shperblimin e pages se pamarre per pune, per ato dite qe eshte shkeputur nga puna, ekspertet, pervec kesaj, kane te drejten e shperblimit per kryerjen e ekspertizes. Ne thirrje duhet te tregohet, ne cilat raste kane te drejte te paguhen personat e thirrur; qe sipas kerkesave te saj, Pala Kontraktuese, nga e cila vjen thirrja, paguan paradhenie per shpenzimet perkatese.

#### Neni 13

#### Vertetesia e dokumentave

1. Dokumentat, te cilat ne territorin e njeres Pale Kontraktuese jane hartuar ose vertetuar nga Gjykata ose personi zyrtar (perkthyes i perhershem, eksperti etj), brenda kufijve te kompetencave te tyre dhe sipas formes se kerkuar dhe te vertetuar me vule, pranohen ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese pa ndonje vertetim tjeter.

2. Dokumentat, te cilat ne territorin e njeres Pale Kontraktuese konsiderohen si zyrtare, jane te vlefshme edhe ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese me te njejten vlere provuese te dokumentave zyrtare.

**Neni 14**

**Shpenzimet lidhur me ndihmen juridike.**

1. Pala Kontraktuese, te ciles i behet kerkesa, nuk do te kerkoje pagimin e shpenzimeve per ndihmen juridike te dhene. Palet Kontraktuese i mbulojne vete shpenzimet qe lindin per ndihmen juridike te dhene ne territorin e tyre.

2. Institucioni juridik, te cilit i drejtohet kerkesa, ve ne dijeni institucionin, nga i cili eshte bere kerkesa per shumen e shpenzimeve. Ne gofte se institucioni nga i cili ka dale kerkesa, i kerkon keto shpenzime nga personi qe eshte i detyruar t'i beje shperblimin, atehere keto shuma shkojne ne dobi te Pales Kontraktuese kerkuese.

**Neni 15**

**Paraqitja e informacionit**

Ministrite e Drejtesise te Paleve Kontraktuese i paraqesin njera-tjetres ne baze kerkeshash, informacion per legjislacionin qe vepron ose qe ka vepruar ne shtetet e tyre dhe per problemet e zbatimit te tij nga institucionet e drejtesise.

**Neni 16**

**Mbrojtja juridike falas.**

Shtetasve te njerës Pale Kontraktuese ne gjyge dhe ne institucione te tjera te Pales tjeter Kontraktuese, u jepet ndihma juridike falas dhe u sigurohet falas shqyrtimi gjyqesor, mbeshtetur ne ate baze dhe ne ato te drejta si dhe shtetasit e vet.

**Neni 17**

**Dergimi i deshmive per gjendjen civile si dhe per dokumentat e tjera.**

Palet Kontraktuese jane te detyruara t'i dergojne njera-tjetres sipas kerkeses, ne rruge diplomatike pa perkthim dhe falas, deshmite per regjistrimin e akteve te gjendjes civile dhe te dokumentave te tjera (arsim, pune etj), te cilat kane te bejne me te drejtat personale dhe interesat pasurore te shtetasve te Pales tjeter Kontraktuese.

**Neni 18**

**Refuzimi i ndihmes juridike**

Ndihma juridike nuk jepet ne qofte se kjo i sjell dem sovranitetit ose sigurimit, apo bie ne kundershtim me parimet kryesore te legjislacionit te Pales Kontraktuese te interesuar.

**PJESA E DYTE**

**DISPOZITA TE VECANTA**

**SEKSIONI I**

**NDIHMA JURIDIKE DHE MARREDHENIET JURIDIKE PER  
CESHTJET CIVILE DHE FAMILJARE**

**Neni 19**

**Perjashtimi nga shpenzimet gjyqesore**

Shtetasve te nje Pale Kontraktuese u njihet ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese, perjashtimi nga pagesa e shpenzimeve gjyqesore po ne ate baze dhe po ne ate mase si dhe shtetasve te vendit te vet.

**Neni 20**

**Dhenia e dokumentave per gjendje personale,  
familjare dhe pasurore**

1. Dokumenti per gjendjen personale, familjare apo pasurore i domosdoshem per perjashtimin nga pagesa e shpenzimeve gjyqesore leshohet nga organi kompetent i Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles kerkuesi ka vendbanimin ose vendqendrimin.
2. Ne qofte se kerkuesi nuk ka vendbanim ose vendqendrim ne territorin e Paleve Kontraktuese, atehere mjafton dokumenti i leshuar dhe i vertetuar nga perfaqesia diplomatike ose institucioni konsullor i shtetit te vet.
3. Gjykata qe merr vendimin mbi kerkesen per perjashtimin nga pagesa e shpenzimeve gjyqesore, mund te kerkoje nga organi qe leshon dokumentin shpjegime plotesuese.

**Neni 21**

**Kompetenca e gjykatave**

1. Ne qofte se kjo Marreveshje nuk vendos ndryshe, gjykatat e seciles Pale Kontraktuese jane kompetente te shqyrtojne ceshtje civile dhe familjare, ne qofte se i padituri ka vendbanimin ne territorin e vet. Per kerkesat e personave juridike ato jane kompetente ne qofte se ne territorin e nje Pale ndodhet nje organ administrativ, perfaqesi apo filial i personit juridik.

2. Gjykatat e Paleve Kontraktuese shqyrtojne ceshtje edhe ne rastet e tjera ne qofte se per kete ka marreveshje me shkrim nga Palet. Kur ekziston nje marreveshje e tille gjykata e pushon ceshtjen me kerkesen e te paditurit ose ne qofte se kjo kerkesa eshte bere para paraqitjes se kundershtimeve qe jane ne thelb te padise. Kompetenca ekskluzive e gjykatave nuk mund te ndryshohet me marreveshje te Paleve.

3. Ne rastin e fillimit te shqyrtimit te ceshtjes midis po atyre paleve, per po ate objekt dhe mbi ate baze, ne gjykatat e te dyja Paleve Kontraktuese, kompetente ne perputhje me kete Marreveshje, eshte gjykata, e cila ka filluar ceshtjen. Per ceshtjen e paraqitur me vone pushon shqyrtimi i saj.

**Neni 22**

**Zotesia juridike dhe zotesia per te vepruar**

1. Zotesia per te vepruar e personit fizik percaktohet nga legjislacioni i Pales Kontraktuese, shtetas i te ciles eshte ky person.

2. Zotesia juridike e personit juridik percaktohet sipas ligjit te Pales Kontraktuese, ne territorin e te ciles ai eshte themeluar.

**Neni 23**

**Hegja e zotesise per te vepruar**

1. Per heqjen e zotesise per te vepruar zbatohet legjislacioni dhe jane kompetente institucionet e Paleve Kontraktuese, shtetas i te ciles eshte ai person qe i hiqet zotesia per te vepruar.

2. Ne qofte se institucioni i njeres Pale vendos qe ka baze per t'i hequr zotesine per te vepruar nje shtetasi tjeter te Pales Kontraktuese, vendbanimi ose vendqendrimi i te cilit ndodhet ne territorin e kesaj Pale Kontraktuese, atehere vihet ne dijeni per kete institucioni perkates i Pales tjeter Kontraktuese.



Ne gofte se institucioni i vene ne dijeni ne kete menyre do te deklarroje se ai i jep te drejte te kryeje veprime te metejshme, institucionit ku gjendet vendbanimi ose vendgendrimi i personit te dhene, apo nuk shprehet brenda nje afati tremujor, atehere ky institucion i vendbanimit ose vendgendrimit te ketij personi mund te shtroje ceshtjen per heqjen e zotesise per te vepruar ne perputhje me legjislacionin e shtetit te vet, ne gofte se shkaku i heqjes se zotesise per te vepruar parashikohet edhe nga legjislacioni i Pales tjeter Kontraktuese, shtetas i te ciles eshte ky person. Vendimi per heqjen e zotesise per te vepruar duhet t'i dergohet institucionit te Pales tjeter Kontraktuese.

3. Dispozitat e pikave 1 dhe 2 te ketij neni zbatohen edhe ne rastin e anulimit te zotesise per te vepruar.

#### Neni 24

Ne rastet kur nuk pritet shtyrje, institucioni i vendbanimit ose vendgendrimit te personit qe i nenshtrohet heqjes se zotesise per te vepruar dhe qe eshte shtetas i Pales tjeter Kontraktuese, mundet te marre vete masa te domosdoshme per mbrojtjen e ketij personi ose te pasurise se tij. Urdherimet qe jane marre lidhur me keto masa, i duhen derguar institucionit perkates te Pales Kontraktuese, shtetas i se ciles eshte ai person. Keto urdherime bien ne gofte se institucioni i kesaj Pale Kontraktuese do te vendose ndryshe.

#### Neni 25

**Shpallja e nje personi si i pagjetur, shpallja e personit te vdekur, vertetimi i faktit te vdekjes**

1. Per ceshtjet e shpalljes te nje personi si i pagjetur, te shpalljes se personit te vdekur, te pranimit te faktit te vdekjes jane kompetente institucionet e asaj Pale Kontraktuese, shtetas i se ciles ka qene ai person ne ate kohe, kur ai, sipas te dhenave te fundit, ishte gjalle.

2. Institucionet e njeres Pale Kontraktuese mund te shpallin shtetasin e Pales tjeter Kontraktuese si person te pagjetur ose te vdekur, si dhe te vertetoje faktin e vdekjes se tij, sipas kerkesave te personave qe jetojne ne ate territor, ne gofte se te drejttat dhe interesat e tyre mbeshteten ne legjislacionin e kesaj Pale Kontraktuese.

3. Ne rastet e parashikuara ne pikat 1 dhe 2 te ketij neni, institucionet e Paleve Kontraktuese zbatojne legjislacionin e shtetit te vet.

Neni 26

Lidhja e martesës

1. Kushtet e lidhjes së martesës për çdo person që do të martohet përcaktohen nga legjislacioni i Pales Kontraktuese, shtetas i së cilës është ai vete. Vec kësaj, duhet të respektohen edhe kërkesat e legjislacionit të Pales Kontraktuese në territorin e së cilës lidhet martesë, në lidhje me rrethanat e lidhjes së martesës.

2. Format e lidhjes së martesës përcaktohen nga legjislacioni i Pales Kontraktuese në territorin e së cilës lidhet martesë.

Neni 27

Marredheniet juridike personale dhe pasurore të bashkeshortëve.

1. Marredheniet juridike, personale dhe pasurore të bashkeshortëve përcaktohen nga legjislacioni i Pales Kontraktuese në territorin e së cilës ata kanë vendbanimin e përbashkët.

2. Në qoftë se njëri nga bashkeshortët jeton në territorin e njëres Pale Kontraktuese, kurse tjetri në territorin e Pales tjetër Kontraktuese, dhe kur të dy bashkeshortët kanë të njëjten shtetësi, atëherë marredheniet e tyre juridike, personale dhe pasurore, përcaktohen nga legjislacioni i Pales Kontraktuese në territorin e së cilës ata kanë pasur vendbanimin e tyre të fundit të përbashkët.

3. Në qoftë se një nga bashkeshortët është shtetas i njëres prej Paleve Kontraktuese dhe tjetri i Pales tjetër Kontraktuese dhe njëri banon në territorin e njëres Pale dhe tjetri në atë të Pales tjetër, atëherë marredheniet e tyre juridike, personale dhe pasurore përcaktohen nga legjislacioni i Pales Kontraktuese në territorin e së cilës ata kanë pasur vendbanimin e tyre të fundit të përbashkët.

Neni 28

Zgjidhja e martesës dhe pavlefshmëria e saj.

1. Për zgjidhjen e martesës zbatohet legjislacioni dhe kompetencat e institucioneve të Pales Kontraktuese, shtetas të së cilës kanë qenë bashkeshortët në çastin kur kanë paraqitur kërkesën. Në qoftë se bashkeshortët e kanë vendbanimin në territorin e Pales tjetër Kontraktuese janë kompetente gjithashtu edhe institucionet e kësaj Pale Kontraktuese.

2. Ne qofte se ne momentin e paraqitjes se kerkeses per zgjidhjen e marteses, njeri nga bashkeshortet eshte shtetas i njeres Pale Kontraktuese, kurse tjetri i Pales tjetere Kontraktuese dhe njeri prej tyre banon ne territorin e njeres Pale, ndersa tjetri ne territorin e Pales tjetere Kontraktuese, atehere kompetente jane institucionet e te dy Paleve Kontraktuese. Per keto raste zbatohet legjislacioni i shtetit te vet.

3. Lidhur me pavlefshmerine e marteses zbatohet legjislacioni i Pales Kontraktuese, qe sipas nenit 26, zbatohet per lidhjen e marteses. Per kete, kompetenca e gjykatave percaktohet perkatesisht ne baze te pikave 1 dhe 2 te ketij neni.

#### **Marredheniet juridike midis prinderve dhe femijeve**

##### **Neni 29**

Percaktimi dhe kundershtimi i atesise dhe i lindjes se femijes nga kjo martese vendoset ne perputhje me legjislacionin e Pales Kontraktuese shtetas i se ciles eshte femija qe ne lindje.

##### **Neni 30**

1. Marredheniet juridike midis prinderve dhe femijeve percaktohen nga legjislacioni i Pales Kontraktuese, ne territorin e se ciles ata kane vendbanimin e perbashket.

2. Ne qofte se vendbanimi i ndonjerit prej prinderve ose i femijeve ndodhet ne territorin e Pales tjetere Kontraktuese, atehere te drejtat juridike midis tyre percaktohen nga legjislacioni i Pales Kontraktuese, shtetas i se ciles eshte femija.

##### **Neni 31**

Marredheniet juridike midis femijes se lindur jashte martese, nenes dhe atit te vet, percaktohen sipas legjislacionit te Pales Kontraktuese, shtetas i se ciles eshte femija.

##### **Neni 32**

Per marrjen e vendimeve lidhur me marredheniet juridike, te permendura ne nenet 29-31, jane kompetente gjykatat e Paleve Kontraktuese, legjislacioni i te cilave duhet te zbatohet ne keto raste.

Ne qofte se paditesi dhe i padituri banojne ne territorin e njeres Pale Kontraktuese, jane kompetente gjithashtu edhe gjykatat e kesaj Pale Kontraktuese, duke respektuar dispozitat e neneve 29-31.

### **Biresimi**

#### **Neni 33**

1. Per biresimin zbatohet legjislacioni i Paleve Kontraktuese, shtetas i se ciles eshte biresuesi.

2. Ne qofte se femija biresohet nga bashkeshortet, kur njeri prej tyre eshte shtetas i njetres Pale, ndersa tjetri eshte shtetas i Pales tjetere Kontraktuese, atehere biresimi duhet t'u pergjigjet kerkesave te legjislacionit qe vepron ne territorin e te dy Paleve Kontraktuese.

3. Ne qofte se femija eshte shtetas i njeres Pale Kontraktuese, kurse biresuesi eshte shtetas i Pales tjetere Kontraktuese, atehere per biresimin e tij duhet te merret sipas rastit miratimi i femijes, ne qofte se kjo kerkohej sipas ligjit te Pales Kontraktuese, shtetas i se ciles eshte, i perfagesuesit te tij ligjor dhe ne cdo rast i organit kompetent shteteror te kesaj Pale kontraktuese.

#### **Neni 34**

1. Vendimin per biresim eshte kompetent ta jape institucioni i Pales Kontraktuese, shtetas i se ciles eshte biresuesi.

2. Ne rastet e parashikuara ne piken 2 te nenit 33 te kesaj Marreveshje eshte kompetent institucioni i Pales Kontraktuese, ne territorin e se ciles bashkeshortet kane ose kishin vendbanimin e fundit te perbashket ose vendqendrimin.

### **Kujdestaria (Kujdestaria dhe mbikqyrja)**

#### **Neni 35**

1. Per ceshtjen e kujdestarise se shtetasve te Paleve Kontraktuese, perderisa kjo Marreveshje nuk parashikon ndryshe, kompetent eshte organi i kujdestarise se Pales Kontraktuese, shtetas i se ciles eshte personi i vene ne kujdestari. Ne kete rast zbatohet legjislacioni i kesaj Pale Kontraktuese.

2. Marredheniet juridike midis kujdestarit dhe personit te vene ne kujdestari, percaktohen nga legjislacioni i Pales Kontraktuese, organi i kujdestarise te te ciles ka caktuar kujdestarin.

#### Neni 36

1. Ne gofte se masat per kujdestarine jane te domosdoshme ne interes te personit te vene ne kujdestari, vendbanimi ose vendqendrimi apo pasuria e te cilit ndodhet ne territorin e Pales Kontraktuese, menjehere duhet te njoftoje organin kompetent te kujdestarise sipas pikes 1 te nenit 35 te Pales Kontraktuese.

2. Ne raste urgjente, organi i kujdestarise i Pales tjeter Kontraktuese mund te marre vete masat e duhura, por ai duhet menjehere te njoftoje organin kompetent te kujdestarise per masat paraprake qe jane marre sipas pikes 1 te nenit 35. Masat e marra mbeten ne fuqi derisa ky organ te marre nje vendim tjeter.

#### Neni 37

1. Organi kompetent i kujdestarise sipas pikes 1 te nenit 35 mund t'ia kaloje kujdestarine organeve perkatese te Pales tjeter Kontraktuese ne gofte se vendbanimi ose vendqendrimi, ose pasuria e personit te marre ne kujdestari ndodhet ne kete shtet. Transferimi behet real vetem atehere, kur organi te cilit i kerkohet, e pranon marrjen e kujdestarise dhe njofton per kete organin kerkues.

2. Organi, qe sipas pikes 1 te ketij neni e pranon kujdestarine, e realizon ate ne perputhje me legjislacionin e shtetit te vet. Ai nuk ka te drejte nderkaq te marre vendim per ceshtje qe lidhen me statusin e personit, qe ndodhet nen kujdestarine, por mund te jape leje per lidhjen e marteses qe eshte e domosdoshme sipas legjislacionit te Pales Kontraktuese, shtetas i se ciles eshte ky person.

#### Marredheniet juridike pasurore

#### Neni 38

#### Pronesia

1. Pronesia mbi pasurine e paluajtshme percaktohet sipas legjislacionit te Pales Kontraktuese, ne territorin e se ciles ndodhet pasuria e paluajtshme.

2. Pronesia mbi mjetet e transportit, qe perfshihen ne inventarin shteteror, percaktohet sipas ligjit te Pales Kontraktuese, ne territorin e se ciles ndodhet organi qe ka bere regjistrimin e mjetit te transportit.

3. Lindja dhe pushimi i pronesise se luajteshme dhe te paluajteshme percaktohet sipas legjislacionit te Pales, ne territorin e se ciles pasuria ndodhet ne momentin kur kishte vend veprimi ose ndonje rrethane tjeter qe ka sherbyer si baze per lindjen ose pushimin e kesaj te drejte. Lindja dhe pushimi i pronesise ose pronesia e nje sendi tjeter qe eshte objekt i nje veprimi juridik, percaktohet sipas legjislacionit te vendit te kryerjes se veprimit juridik, ne qofte se marreveshja e Paleve nuk parashikon ndryshe.

#### Neni 39

#### Forma e veprimit juridik

1. Forma e veprimit juridik percaktohet, sipas legjislacionit te vendit te lidhjes se saj.

2. Forma e veprimit juridik per pasuri te paluajteshme dhe e te drejtave mbi te, percaktohet sipas legjislacionit te Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles ndodhet kjo pasuri.

#### Neni 40

#### Shperblimi i demit

1. Detyrimi per shperblimin e demit, pervec atyre qe lindin nga kontratat dhe veprimet e tjera juridike, percaktohen nga ligji i Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles kishte vend veprimi ose nje tjeter rrethane, qe ka sherbyer si baze per kerkesen e shperblimit te demit.

2. Ne qofte se shkaktari i demit dhe i demtuari jane shtetas te nje Pale Kontraktuese, zbatohet legjislacioni i Pales Kontraktuese, ne gjykaten e se ciles eshte bere kerkesa.

3. Per ceshtjet e permendura ne pikat 1 dhe 2 te ketij neni, kompetente eshte gjykata e Pales Kontraktuese, ne territorin e se ciles eshte kryer veprimi ose nje rrethane tjeter qe ka sherbyer si baze per kerkesen e shperblimit te demit. I demtuari mund te paraqese kerkesen edhe ne gjykaten e Pales Kontraktuese, ne territorin e se ciles e ka vendbanimin personi qe ka shkaktuar demin.

## Trashegimia

### Neni 41

#### Parimi i barazise ne te drejttat

Shtetasit e njerës Pale Kontraktuese kane te drejta te barabarta me shtetasit e Pales tjetër Kontraktuese, qe banojne ne territorin e saj, ne lidhje me zotesine per te hartuar ose revokuar testamentin per pasurine qe ndodhet ne territorin e Pales tjetër Kontraktuese, ose ne lidhje me te drejttat qe duhet te realizohen atje, si dhe ne lidhje me zotesine per te fituar me trashegimi pasuri ose te drejttat. Pasuria ose te drejttat i kalojne atyre po me ato kushte, ne te cilat jane vendosur per shtetasit e vete Pales Kontraktuese, qe jetojne ne territorin e saj.

### Neni 42

#### E drejta e trashegimise

1. E drejta e trashegimise te pasurise se luajteshme rregullohet me ligjin e Pales Kontraktuese, ne territorin e se ciles trashegimlensesi ka patur vendbanimin e fundit te perhershem.
2. E drejta e trashegimise te pasurise se paluajteshme rregullohet me legjislacionin e Pales Kontraktuese, ne territorin e se ciles ndodhet pasuria.

### Neni 43

#### Pasuri pa zot

Ne qofte se sipas legjislacionit te Paleve Kontraktuese, pasuria e patrasheguar si pasuri pa zot (e trasheguar nga shteti sipas ligjit) kalon ne pronesi te shtetit, atehere pasuria e luajteshme i kalon shtetit, shtetas i te cilit ishte trashegimlensesi ne momentin e vdekjes, ndersa pasuria e paluajteshme kalon ne pronesi te shtetit, ne territorin e te cilit ndodhet ajo.

### Neni 44

#### Forma e testamentit

Forma e testamentit percaktohet nga ligji i Pales Kontraktuese, shtetas i se ciles ishte trashegimlensesi ne momentin e berjes se testamentit. Per kete mjafton qe te respektohet legjislacioni i Pales Kontraktuese, ne territorin e se ciles eshte hartuar testamenti. I njejti rregull zbatohet edhe ne lidhje me revokimin e testamentit.

### Kompetenca per ceshtjet e trashegimise

1. Veprimet per ceshtjet e trashegimise se pasurise se luajteshme me perjashtim te rasteve qe parashikon pika 2 e ketij neni, kryhen nga institucionet e Pales Kontraktuese, ne territorin e se ciles trashegimlensesi kishte vendbanimin e fundit te perhershem.
2. Ne qofte se e gjithje pasuria e luajteshme e trasheguar ndodhet ne territorin e Pales Kontraktuese, ku trashegimlensesi nuk kishte vendbanimin e fundit te perhershem, atehere, sipas deklarates se trashegimtarit ose te marresit qe refuzon, ne qofte se me kete jane dakord te gjithje trashegimtarët, veprimet per ceshtjen e trashegimise i kryejne institucionet e kesaj Pale Kontraktuese.
3. Veprimet per ceshtjet e trashegimise se pasurise se paluajteshme i kryejne institucionet e Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles ndodhet kjo pasuri.
4. Rregullat e ketij neni zbatohen edhe per ceshtjet e trashegimise.

### Masat per ruajtjen e pasurise trashegimore

1. Organet e njeres Pale Kontraktuese ne perputhje me legjislacionin e tyre, marrin masat e domosdoshme per ruajtjen e pasurise se trasheguar, qe ndodhet ne territorin e tij dhe qe eshte lene nga nje shtetas i Pales Kontraktuese.
2. Organet pergjegjese per marrjen e masave per ruajtjen e pasurise trashegimore pas vdekjes se shtetasit te Pales tjeter Kontraktuese jane te detyruar te njoftojne menjehere konsullin e kesaj Pale Kontraktuese per vdekjen e trashegimlensetit dhe per personat, qe kane deklaruar per te drejtat e tyre mbi trashegimine, per rrethanat e njohura prej tyre qe lidhen me personat qe kane te drejte mbi trashegimine dhe per vendin e ndodhjes se tyre, per qenien e testamentit, per permasat dhe vleren e trashegimise si dhe per faktin se cfare masash jane marre per ruajtjen e trashegimise.
3. Me kerkesen e perfaqesise diplomatike ose te institucionit konsullor atij i kalojne pasuria e luajteshme e trasheguar si dhe dokumentat e te vdekurit.



**Neni 47**

Perfaqesia diplomatike ose institucioni konsullor i njerës Pale Kontraktuese ka të drejtë të perfaqësojë interesat e shtetasve të kësaj Pale Kontraktuese për çështjet e trashëgimise, përpara organeve të Pales tjetër Kontraktuese pa ndonjë autorizim të vecantë, në qoftë se këta shtetas, nga mungesa ose për shkak të tjera të arsyeshme, nuk janë në gjendje në kohën e duhur të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre, dhe nuk kanë caktuar perfaqësues.

**Neni 48**

Në qoftë se shtetasi i një Pale Kontraktuese, gjatë udhëtimit nëpër territorin e Pales tjetër Kontraktuese ku ai ka vendbanim të përhershëm, vdes, atëherë sendet që ai ka, i kalojnë pa asnjë formalitet perfaqësise diplomatike ose institucionit konsullor të Pales Kontraktuese, shtetas i se ciles është i vdekuri.

**Neni 49**

**Kalimi i pasurise trashëgimore**

1. Në qoftë se pasuria e luajtëshme e trashëguar ose shuma e të hollave e fituar nga shitja e pasurise së luajtëshme ose të paluajtëshme të trashëguar pas përfundimit të veprimeve të trashëgimise i përket trashëgimtareve, vendbanimi ose vëndgëndrimi i të cileve ndodhet në territorin e Pales tjetër Kontraktuese, atëherë pasuria e trashëguar ose shuma e të hollave të fituara prej tij i kalojnë perfaqësise diplomatike, ose institucionit konsullor të kësaj Pale Kontraktuese.

2. Institucioni që është kompetent për çështjet e trashëgimise jep urdher për t'ia dhënë pasurine e trashëguar perfaqësise diplomatike ose institucionit konsullor.

3. Kjo pasuri mund t'i kalojë trashëgimtareve në qoftë se :

1) Të gjitha kërkesat e kreditorëve të trashëgimlënës, që janë paraqitur në afatin e caktuar nga legjislacioni i Pales Kontraktuese, ku ndodhet pasuria e trashëguar janë paguar ose siguruar;

2) Jantë paguar ose siguruar të gjitha taksat që lidhen me trashëgimine;

3) Institucionet kompetente japin, po të jete e domosdoshme, leje për transferimin e pasurise së trashëguar.

4. Transferimi i shumave të të hollave kryhet në përputhje me legjislacionin që vepron në territorin e Pales Kontraktuese.

**Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve**

Neni 50

**Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve per ceshtjet civile dhe familiare si dhe per shperblimin e demit te rrjedhur nga vepra penale**

Palet Kontraktuese njohin dhe ekzekutojne reciprokisht vendimet e institucioneve te drejtesise qe marrin forme te prere per ceshtjet civile dhe familiare si dhe vendimet lidhur me shperblimin e demit te rrjedhur nga vepra penale. Ne territorin e Pales Kontraktuese njihen gjithashtu pa veprime te posacme vendimet e organeve te kujdestarise, te organeve te gjendjes civile dhe te institucioneve te tjera per ceshtjet civile e familiare, qe nuk kerkojne ekzekutim per nga karakteri i tyre.

Neni 51

**Shqyrtimi i kerkesave zyrtare per lejimin e ekzekutimit te vendimeve**

1. Shqyrtimi i kerkesave per lejimin e zbatimit te vendimit hyn ne kompetencen e gjykatave te Pales Kontraktuese, ne territorin e se ciles duhet te kryhet ky ekzekutim.
2. Kerkesa per lejimin e ekzekutimit i jepet gjykates qe ka dhene vendimin per ceshtjen ne shkallen e pare. Kerkesa e dhene ne gjykaten qe ka nxjerre vendimin per ceshtjen ne shkalle te pare, i percillet gjykates, e cila eshte kompetente per te marre vendime sipas kerkeses.
3. Permbajtja e kerkeses percaktohet nga legjislacioni i Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles duhet te behet ekzekutimi.
4. Kerkeses i bashkangjitet nje perkthim i legalizuar ne gjuhen e Pales Kontraktuese te ciles i drejtohet.

Neni 52

Bashke me kerkesen per lejimin e ekzekutimit eshte e domosdoshme te dergohen :

- 1) Kopja e vendimit e vertetuar nga gjykata, dokumenti zyrtar qe vendimi eshte i formes se prere, ne se kjo del nga teksti i vete vendimit.

2) Dokumenti, nga i cili del se te paditurit, i cili nuk ka marre pjese ne proces, i eshte dorezuar, gofte edhe nje here , ne kohe dhe ne forme te rregullt, thirrja per t'u paraqitur ne gjyq.

3) Perkthimet e vertetuara te dokumentave per te cilat behet fjale ne pikat 1 dhe 2 te ketij neni.

Neni 53

Ne gofte se ne gjykate, kur jepet leja per ekzekutimin, linden dryshime, atehere mund t'i kerkohen shpjegime personit qe ka bere kerkesen per zbatimin e vendimit, si edhe te pyetet i detyruari per thelbin e kerkeses, dhe ne rast domosdoshmerie, te kerkohen shpjegime nga gjykata qe ka nxjerre vendimin.

Neni 54

Ekzekutimi i vendimeve

Ekzekutimi i vendimeve rregullohet sipas legjislacionit te Pales Kontraktuese, ne territorin e se ciles duhet te behet ekzekutimi.

Neni 55

Lidhur me shpenzimet gjyqesore per ekzekutimin perdoret legjislacioni i Pales Kontraktuese, ne territorin e se ciles duhet te vihet ne ekzekutim vendimi.

Neni 56

Refuzimi i ekzekutimit te vendimeve gjyqesore

Lejimi i ekzekutimit te vendimeve gjyqesore ose njohja e tyre mund te refuzohen :

1) Ne gofte se personi qe ka bere kerkesen ose i padituri nuk ka marre pjese ne proces, per arsye se atij ose perfaqesuesit te tij, thirrja per ne gjyq nuk i eshte dorezuar ne kohe dhe sipas rregullit;

2) Ne gofte se sipas po atij konflikti juridik ndermjet po atyre Paleve ne territorin e Pales Kontraktuese, ku duhet te njihet dhe te ekzekutohet vendimi, eshte dhene me perpara vendimi qe ka marre forme te prere, ose ne gofte se nga institucioni i kesaj Pale Kontraktuese kishte filluar qe me pare procesi per kete ceshtje;

3) Ne qofte se sipas dispozitave te kesaj Marreveshjeje, ne ndonje rast te paparashikuar nga Marreveshja e tanishme sipas legjislacionit te Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles vendimi duhet te njihet dhe te zbatohet, pra ne kete rast ceshtja kalon ne kompetencen e plote te institucioneve te saj.

**Neni 57**

Dispozitat e neneve 50-56 te kesaj Marreveshjeje per vendimet gjyqesore zbatohen dhe ne marreveshjet qe zgjidhen me pajtim dhe vertetohen nga gjykatat.

**Neni 58**

**Transferimi i sendeve dhe i shumave ne te holla**

Dispozitat per zbatimin e vendimeve nuk prekin legjislacionin e Paleve Kontraktuese per transferimin e shumave ne te holla dhe per transferimin e sendeve te fituara si rezultat i zbatimit te vendimeve.

**SEKSIONI I DYTE**

**Ndihma juridike per ceshtjet penale  
Zbatimi i ndjekjes penale**

**Neni 59**

**Fillimi i ndjekjes penale**

1. Cdo Pale Kontraktuese me kerkesen e Pales tjeter Kontraktuese, ne perputhje me legjislacionin e vet, fillon ndjekjen penale kunder shtetasve te vet, qe dyshohen te kene kryer nje veper penale ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese.

2. Kerkesat per ndjekje penale te dorezuara nga te demtuarit ne perputhje me ligjet e njeres Pale Kontraktuese ne institucionet kompetente te saj ne afate te caktuara, jane te vlefshme edhe ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese.

**Neni 60**

**Kerkesa per fillimin e ndjekjes penale**

1. Kerkesa per fillimin e ndjekjes penale duhet te jete me shkrim dhe te permbaje :

- 1) Emertimin e institucionit te interesuar;
- 2) Pershkrimin e vepres, ne lidhje me te cilen eshte drejtuar kerkesa per fillimin e ndjekjes penale;
- 3) Pershkrim sa me te sakte te kohes dhe vendit te kryerjes se vepres;
- 4) Tekstin e ligjit te Pales Kontraktuese te interesuar ne baze te te cilit cilesohet si veper penale;
- 5) Emrin dhe mbiemrin e personit te dyshimte, te dhena per shtetesine e tij, per vendin e banimit ose te qendrimit, te dhena te tjera per identitetin e tij, por gjithashtu, ne qofte se eshte e mundur, pershkrimin e tipareve te jashtme te ketij personi, fotografia dhe shenjzat e gishterinjve;
- 6) Kerkesa e te demtuarit ne ceshtjen penale, te ngritur me kerkesen e vete te demtuarit dhe per shperblimin e demit, ne qofte se ka te tille;
- 7) Te dhenat per permasat e demit te shkaktuar.

Kerkeses se Pales Kontraktuese te interesuar i bashkangjiten materialet dhe provat e hetimit paraprak. Gjate dorezimit te mjeteve qe kane sherbyer per kryerjen e vepres penale ose qe kane rene ne dore te te pandehurit si rezultat i kesaj vepre penale, duhet marre parasysh dispozita e pikes 3 te nenit 73.

2. Ne qofte se personi ne castin e dergimit te kerkeses per fillimin e ndjekjes penale sipas pikes 1 te nenit 59 mbahet nen mbikqyrje ne territorin e Pales Kontraktuese, e cila ka bere kerkesen per fillimin e nje ndjekje te tille, ai cohet ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese. Shoqerimi forcerisht i personit qe mbahet i ndaluar ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese sanksionohet nga personi zyrtar qe ushtron kontroll mbi hetimin e ceshtjes. Dorezimi i personit te ndaluar behet sipas pikes 1 te nenit 71 te kesaj Marreveshjeje.

**Ekstradimi**

**Neni 61**

**Veprat penale qe passjellin ekstradimin**

1. Palet Kontraktuese jane te detyruara, ne perputhje me

dispozitat e kesaj Marreveshjeje, qe sipas nje kerkese te vecante t'i dorezojne njeri-tjetrit personat qe ndodhen ne territorin e tyre, per t'i marre ne pergjegjesi penale ose per venien ne zbatim te nje vendimi penal.

2. Ekstradimi behet per vepra, te cilat ne perputhje me ligjet e te dy Paleve Kontraktuese quhen vepra penale dhe per kryerjen e te cilave parashikohet denimi ne formen e heqjes se lirise per me shume se nje vit ose nje tjetër denim me i rende. Ekstradimi per zbatimin e denimit behet ne rastin kur gjykohen vepra penale te tilla, qe ligji parashikon heqjen e lirise per nje afat me te madh se sa gjashte muaj ose nje denim me te rende.

#### Neni 62

#### Refuzimi per ekstradim

Ekstradimi nuk behet ne qofte se :

1) Personi, ndaj te cilit eshte drejtuar kerkesa per ekstradim eshte shtetas i Pales Kontraktuese te kerkuar, ose personi te cilit ne kete shtet i eshte dhene e drejta e strehimit.

2) Ndjekja penale, ne perputhje me legjislacionin e te dy Paleve Kontraktuese, ngrihet vetem mbi kerkesen private te te demtuarit.

3) Ne momentin e marrjes se kerkeses, ndjekja penale ne perputhje me legjislacionin e Pales Kontraktuese te interesuar nuk mund te filloje ose vendimi nuk mund te zbatohet si rezultat i kalimit te afatit te parashkrimit ose per shkak te nje baze tjetër ligjore.

4) Per sa i perket personit, per ekstradimin e te cilit eshte drejtuar kerkesa ne territorin e Pales Kontraktuese te kerkuar per po ate veper penale qe eshte dhene vendimi i denimit ose vendimi per pushimin e shqyrtimit gjygesor, i cili ka marre forme te prere.

Ekstradimi mund te refuzohet ne qofte se vepra penale ne lidhje me te cilin eshte drejtuar kerkesa pe ekstradim eshte kryer ne territorin e Pales Kontraktuese te kerkuar.

Ne rast refuzimi per ekstradim, Pala e kerkuar njofton Palen qe kerkon shkakun e refuzimit.

#### Neni 63

#### Shtyrja e afatit te ekstradimit

Ne qofte se personi, per te cilin eshte drejtuar kerkesa per ekstradim, eshte marre ne pergjegjesi penale ose eshte duke

vuajtur denimin per nje tjeter veper penale, ne territorin e Pales Kontraktuese te kerkuar, ekstradimi mund te shtyhet deri ne perfundimin e ndjekjes penale, mbarimin e afatit te denimit ose lirimin per cdo arsye ligjore.

**Neni 64**

**Ekstradimi i perkohshem**

Ne gofte se shtyrja e ekstradimit, e parashikuar ne nenin 63 mund te sjelle me vete mbarimin e afatit te parashkrimit te ndjekjes penale ose te veshtiresoje seriozisht hetimin e vepres penale, me kerkese te argumentuar mund te behet ekstradim i perkohshem, me kusht, qe personi i kerkuar do te kthehet menjehere pas kryerjes se veprimeve proceduriale, per te cilat ai ishte ekstraduar dhe jo me vone se tre muaj nga dita e ekstradimit.

**Neni 65**

**Ekstradimi sipas kerkeses se disa shteteve**

Ne gofte se kerkesa per ekstradim e te njejtit person eshte bere nga disa shtete, atehere ceshtja, se cila prej tyre eshte e pranueshme, vendoset nga Pala Kontraktuese e kerkuar.

**Neni 66**

**Kufijte e ndjekjes penale te personit te ekstraduar**

1. Pa pelqimin e Pales Kontraktuese dorezuese, personi i ekstraduar nuk mund te merret ne pergjegjesi penale ose t'i nenshtrohet denimit lidhur me ndonje veper tjeter penale, pervec atij qe perbente bazen e ekstradimit.
2. Ai nuk mund gjithashtu, t'i dorezohet nje shteti te trete pa pelqimin e Pales Kontraktuese qe e ka dorezuar.
3. Nuk kerkohet pelqimi i Pales Kontraktuese qe ka dorezuar personin e ekstraduar gjate pesembedhjete diteve mbas mbarimit te ndjekjes penale apo kryerjes se denimit ose lirimit te tij, i cili per cfaredo arsye ligjore, nuk eshte larguar nga territori i Pales Kontraktuese qe kerkon ose, ne gofte se ky person eshte kthyer me vullnetin e tij, pasi qe larguar qe andej. Ne kete afat nuk perfshihet koha gjate se ciles personi i dorezuar nuk mund ta braktiste territorin e Pales Kontraktuese, qe e ka kerkuar per rrethana qe nuk varen prej tij.

**Neni 67**

**Kerkesa per ekstradim**

1. Kerkesa per ekstradim duhet te paraqitet ne forme te shkruar dhe te permbaje:

- 1) Emertimin e institucionit qe e kerkon;
- 2) Tekstin e ligjit te Pales Kontraktuese kerkuese, ne baze te te cilit vepra perben veper penale;
- 3) Mbiemrin dhe emrin e personit per te cilin behet kerkesa qe te ekstradohet, te dhena per shtetesine e tij, vendbanimin apo vendqendrimin ose te dhena te tjera per personin e tij, si edhe, brenda mundesive, pershkrimin e anes se jashtme te tij, fotografine dhe shenjat e gishterinjve;
- 4) Masa e demit material te shkaktuar.

2. Kerkeses per ekstradim per ndjekje penale duhet t'i bashkangjitet nje kopje e vertetuar e vendimit per mbajtjen ne arrest bashke me pershkrimin e rrethanave faktike te ceshtjes. Kerkeses per ekstradim per venien ne ekzekutim te vendimit penal duhet t'i bashkangjiten nje kopje e vendimit te formes se prere bashke me tekstin e ligjit penal ne baze te te cilit personi eshte denuar. Ne qofte se i denuari e ka kryer nje pjese te denimit jepen gjithashtu te dhena edhe per kete.

**Neni 68**

**Mbajtja ne arrest per ekstradim**

Pasi merr kerkesen per ekstradim Pala Kontraktuese merr menjehere masa per te mbajtur ne arrest personin ndaj te cilit eshte derguar kerkesa per ekstradim me perjashtim te rasteve kur, ne perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshjeje, ekstradimi nuk lejohet.

**Neni 69**

**Te dhena plotesuese**

1. Pala Kontraktuese qe ka marre kerkesen mund te drejtohet per te dhenat plotesuese nese kerkesa per ekstradim nuk i permban te dhenat e domosdoshme per te cilat behet fjale ne nenin 67. Pala tjeter Kontraktuese duhet t'i pergjigjet kesaj kerkesese ne nje afat qe nuk e kalon muajin, ky afat mund te zgjatet edhe pesembehjete dite per arsye te perligjura.



2. Ne qofte se Pala Kontraktuese qe kerkon nuk i paraqet ne afatin e caktuar te dhenat plotesuese, Pala tjeter Kontraktuese mund ta liroje personin qe mbahet ne arrest ne baze te nenit 70 te kesaj Marreveshjeje.

**Neni 70**

**Mbajtja ne arrest perpara ardhjes se kerkeses per ekstradim**

1. Ne rastet urgjente Pala Kontraktuese e kerkuar, me kerkesen e Pales Kontraktuese kerkuese mund te mbaje personin ne arrest edhe perpara marrjes se kerkeses per ekstradim, sic kerkohet ne nenin 67. Ne kerkese duhet referimi ne vendimin per mbajtjen ne arrest ose ne vendimin e formes se prere, lidhur me personin e caktuar si dhe shenimin ne formen e shkruar.

Kerkesa mund te dergohet me poste, telegraf ose cdo lloj menyre ne forme te shkruar.

2. Personi mbahet ne arrest gjithashtu edhe pa dergimin e kerkeses qe perfshihet ne piken 1 te ketij neni, ne qofte se ka te dhena te mjaftueshme se ky person ka kryer ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese nje veper penale qe perligj ekstradimin.

3. Per mbajtjen ne arrest sipas pikave 1 dhe 2, si edhe per shkaqet qe permenden ne piken 1 te ketij neni, per kerkesen qe nuk plotesohet duhet vene menjehere ne dijeni Pala tjeter Kontraktuese.

4. Personi qe mbahet ne arrest sipas pikave 1 dhe 2 duhet te lirohet, ne qofte se gjate nje muaji qe nga dita e kerkeses per mbajtjen ne arrest, nuk vjen kerkesa per ekstradim nga Pala tjeter Kontraktuese. Ky afat, me kerkese te Pales Kontraktuese kerkuese, mund te shtyhet deri ne pesembedhjete dite.

**Neni 71**

**Kryerja e ekstradimit**

1. Pala Kontraktuese e kerkuar njofton Palen Kontraktuese kerkuese per vendimin e vet, lidhur me ekstradimin, duke e vene ne dijeni per vendimin dhe kohen e ekstradimit.

2. Ne qofte se Pala Kontraktuese kerkuese nuk e merr personin qe duhet ekstraduar gjate pesembedhjete diteve pas dates se caktuar per kete ekstradim, ky person duhet te lirohet nga arresti. Me kerkese te Pales Kontraktuese kerkuese ky afat mund te zgjatet jo me shume se pesembedhjete dite.

**Neni 72**

**Ekstradimi i perseritur**

Ne gofte se personi i shmanget ndjekjes penale ose kryerjes se denimit dhe kthehet ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese prej se ciles kerkohet, sipas kerkeses se Pales Kontraktuese kerkuese mund te ekstradohet perseri. Ne kete rast, nuk ka nevojte te dergohen bashke me kerkesen dokumentat qe permenden ne nenin 67.

**Neni 73**

**Dorezimi i objekteve**

1. Pala Kontraktuese prej se ciles kerkohet ekstradimi, i jep Pales Kontraktuese kerkuese objektet qe kane sherbyer per kryerjen e vepres penale qe passjell ekstradimin sipas nenit 61, si edhe objektet qe ruajne gjurmet e vepres penale ose te marra ne rruge kriminale. Keto objekte dorezohen me kerkese edhe ne ate rast kur ekstradimi i personit nuk mund te behet per arsye te vdekjes se tij ose per rrethana te tjera.

2. Pala Kontraktuese e kerkuar mund te vonoje per nje fare kohe dhenien e objekteve qe permenden ne piken 1 te ketij neni, ne gofte se ato jane te domosdoshme per nje ceshtje tjeter penale.

3. E drejta e personave te trete mbi objektet e Pales Kontraktuese kerkuese mbetet ne fuqi. Pasi kryhet puna me to per nje ceshtje tjeter penale, ato duhet t'i kthehen Pales Kontraktuese qe i ka dhene.

**Neni 74**

**Kalimi tranzit**

1. Cdo Pale Kontraktuese me kerkese te Pales tjeter Kontraktuese lejon ne territorin e vet kalimin tranzit te personave te ekstraduar nga shteti i trete ne vendin e Pales tjeter Kontraktuese. Palet Kontraktuese nuk jane te detyruara te lejojne kalimin e personave, ekstradimi i te cileve nuk lejohet sipas dispozitave te kesaj Marreveshjeje.

2. Kerkesa per lejimin e kalimit, formulohet dhe dergohet ne po ate menyre si edhe kerkesa per ekstradim.

3. Institucionet kompetente te Paleve Kontraktuese bien dakord ne cdo rast te vecante per menyren, rrugen dhe kushtet e tjera te kalimit tranzit.

4. Shpenzimet qe lidhen me kalim tranzit i merr vete Pala Kontraktuese kerkuese.

**Neni 75**

**Prania e perfaqesueve te Paleve Kontraktuese  
ne dhenien e ndihmes juridike per ceshtje penale**

Perfaqesuesit e njeres nga Palet Kontraktuese me pelqimin e Pales tjeter Kontraktuese mund te jene te pranishem gjate kryerjes se dhenies se ndihmes juridike per ceshtje penale te Pales tjeter Kontraktuese.

**Neni 76**

**Te dhena per gjykimin e personave**

Sipas kerkesave qe bejne, Palet Kontraktuese i paraqesin njera-tjetres te dhena per gjykimin e personave te denuar me pare nga gjykatat e tyre, nese keta persona merren ne pergjegjesi penale ne territorin e Pales Kontraktuese kerkuese.

**Neni 77**

**Te dhena per rezultatet e ndjekjes penale**

Palet Kontraktuese njoftojne njera-tjetren me te dhena per rezultatet e ndjekjes penale te personit ndaj te cilit eshte derguar kerkesa per ndjekje penale si dhe per ekstradimin e tij.

Se bashku me kerkesen dergohet kopja e vendimit te formes se prere ose e nje vendimi tjeter perfundimtar.

**Neni 78**

**Te dhena per vendimet penale**

Palet Kontraktuese i japin cdo vit njera-tjetres te dhena per vendime penale te gjykatave te tyre qe kane marre forme te prere, te marra nga gjykatat e njeres Pale kontraktuese ne lidhje me shtetasit e Pales tjeter Kontraktuese.

**PJESA E TRETE**

**DISPOZITAT PERFUNDIMTARE**

**Neni 79**

**Kjo Marreveshje i nenshtrohet ratifikimit dhe hyn ne fuqi**

tridhjetë dite pas shkëmbimit të instrumentave të ratifikimit i cili do të mbahet në \_\_\_\_\_

**Neni 80**

1. Kjo Marreveshje do të veprojë gjatë pesë vjeteve që nga dita e hyrjes në fuqi.

2. Marreveshja do të mbetet në fuqi për periudha të metejshme pesëvjeçare në qoftë se njëra Pale Kontraktuese nuk e denoncon atë, duke njoftuar për këtë me note Palen tjetër Kontraktuese gjatë muaj para dates së mbarimit të afatit të kësaj Marreveshjeje.

**Neni 81**

1. Që nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Marreveshjeje pushon së vepruari midis Paleve Kontraktuese, Marreveshja e lidhur midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike "Për dhenien e ndihmes juridike për çështjet civile, familjare dhe penale" e nënshkruar në Moskë më 30 qershor 1958.

2. Pushimi i veprimeve të Marreveshjes së përmendur në pikën 1 të këtij neni nuk i heq forcën ligjore vendimeve të gjykatave të njërës Pale Kontraktuese, në qoftë se vendimet e saj janë njohur dhe ekzekutohen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në bazë të kësaj Marreveshjeje.

Bere në Tiranë në dy kopje secila, në gjuhët shqip dhe rusisht dhe të dy tekstet kanë të njëjten fuqi, më 30.10.1995.

**PER REPUBLIKEN E SHQIPERISE**

**PER FEDERATEN RUSE**

**MINISTRI**

  
**Hektor FRASHERI**

**MINISTRI**

  
**Valentin A. KOVALEV**